



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË FONDEVE NË MIRËBESIM PËR VITIN 2020

Prishtinë, korrik 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkohet falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Valon Tolaj, Drejtor Menaxhues

Adresa: Rr. Agim Ramadani nr.23, Prishtinë, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Fondeve në Mirëbesim për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Fondeve në Mirëbesim (FM), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Fondeve në Mirëbesim, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Fondeve në Mirëbesim me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të FM kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondeve në Mirëbesim.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Fondeve në Mirëbesim është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Fondeve në Mirëbesim në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme

pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Fondeve në Mirëbesim me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Fondeve në Mirëbesim.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të

rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të përmirësojnë kontrollin e brendshëm lidhur me pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve në mirëbesim dhe vonesat që ndërlidhen me arkëtimin e të hyrave nga qiraja. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

2.1 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Të hyrat nga qiraja

AKP-Fondet në Mirëbesim realizon të hyra nga asetet e dhëna me qira të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH), në likuidim dhe në tranzicion. Gjatë vitit 2020 këto të hyra ishin në vlerë prej 3,204,640€, me një zvogëlim prej 2,257,796€, krahasuar me vitin 2019. Si rezultat i gjendjes së shkaktuar nga pandemia Covid-19, Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e 25 qershorit 2020 kishte marrë vendim me të cilin e autorizon Menaxhmentin dhe Autoritetin e Likuidimit që të lirojë nga detyrimet e papaguara në lartësinë 100%, të qirave për periudhën që kanë pasur të ndaluar aktivitete sipas vendimeve të Qeverisë, si dhe faljen e detyrimeve të papaguara të qirasë në vlerë 70% për ato biznese që kanë pasur të lejuar ushtrimin e veprimtarisë mirëpo kanë pasur rënie të madhe të qarkullimit.

Çështja B1 - Arkëtimi me vonesë i të hyrave nga qiratë

Gjetja Afati i pagesës së qirasë për shfrytëzimin e aseteve/objekteve të NSH-ve në likuidim është pesë ditë nga pranimi dorëzimi i faturës.

Gjatë testimeve tona në një rast (faturat e lëshuara nga AKP me datën 23.06.2020 dhe datën 10.08.2020) nuk është paguar qiraja mujore me kohë dhe është akumuluar borxh nga qiramarrësi për një periudhë më të gjatë se një muaj në vlerë 145,958€.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos funksionimit të mirë të mekanizmave për monitorimin dhe kontrollin e qiramarrësve dhe gjendjes financiare të shkaktuar tek ndërmarrjet nga pandemia Covid 19.

Ndikimi Mos arkëtimi me kohë i të hyrave nga qiraja rritë rrezikun që mos të arrihen objektivat për mbledhjen e të hyrave me kohë, duke ndikuar edhe në rritjen e llogarive të arkëtueshme.

Rekomandimi B1 Kryesuesi i Bordit përmes Drejtorit Menaxhues duhet të siguroj që mekanizmat e kontrollit, e monitorojnë dhe i shtojnë kontrollin tek

qiramarrësit që vonohen në kryerjen e pagesave të qirasë në mënyrë që
arkëtimin i të hyrave të bëhet me kohë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Të hyrat nga shitja e asetëve

Të hyrat e realizuara nga shitja paraqesin hyrjet në llogaritë bankare të Ndërmarrjeve Shoqërore (Fondet në Mirëbesim) të cilat administrohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit. Të hyra nga shitja e asetëve janë pagesat e pranuar lidhur me privatizimin dhe likuidimin e asetëve. Gjatë vitit 2020, janë realizuar të hyra nga shitja e asetëve në vlerë 14,822,298€, prej tyre 8,389,530€, janë nga shitja e asetëve përmes valëve të likuidimit, 399,775€ nga pagesat e realizuara nga Qeveria për shpronësimin e asetëve, 6,031,159€ nga shitja me negociim direkt dhe 1,834€ janë të hyra nga bartja e së drejtës banesore.

Çështja A1 - Transferi i mjeteve pa memorandum të brendshëm

Gjetja Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP-FM) që të ketë një menaxhim më të mirë të Fondeve në Mirëbesim të cilat administrohen nga ajo, për transferet (transaksionet që ndodhin brenda dhe jashtë llogarive të saj), sipas praktikave të saj përgatit një memorandum të brendshëm, ku përshkruan qëllimin e transferit, burimi i mjeteve emri dhe numri i llogarisë të ndërmarrjes, shuma e transferuar dhe ky memorandum nënshkruhet nga personat përgjegjës që janë të përfshirë në procesin e transaksionit.

Transferi i brendshëm dt.01.04.2020 në vlerë 257,171€ nga llogaria e shpronësimit në llogarinë e përfituesit (Ndërmarrjes Shoqërore), me qëllim që të bëhet më tutje shpërndarja e 20% të punëtorëve të saj, ishte bërë pa memorandum të brendshëm (Memo).

Kjo kishte ndodhur pasi që Drejtori i departamentit të komisioneve profesionale, bazuar në komunikimin elektronik, kishte kërkuar që ky transfer të bëhet pa memo,

Ndikimi Transferi i mjeteve pa memo të brendshme dhe pa miratimin paraprak të personave përgjegjës krijon mundësi që mos të dihet saktë qëllimi i tij apo që transferi të bëhet në llogari jo të duhur.

Rekomandimi A1 Kryesuesi i Bordit përmes Drejtorit Menaxhues duhet të siguroj se mekanizmat e vendosura për kryerjen e transfereve, i zbatojnë praktikën e vendosura për të evituar gabimet eventuale gjatë kryerjes së transfereve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për pranimet dhe pagesat e Fondeve në Mirëbesim

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 1. Pasqyra e pranimeve dhe pagesave për vitet 2019 dhe 2020 në Euro (€)


Përshkrimi	Pranimet /Pagesat Janar-Dhjetor 2019	Gjendja e llogarive me 31 dhjetor 2019	Pranimet /Pagesat Janar-Dhjetor 2020	Gjendja e llogarive me 31 dhjetor 2020
	Pranimet			
Gjithsej pranimet	49,263,508	855,687,74 □	15,471,311	871,159,060
Të hyrat nga shitja e aseteve	41,345,259	756,651,908	14,822,298	771,474,206
Të hyrat nga Qiraja	5,462,436	44,295,090	3,204,640	47,499,730
Interesi i fituar	-	34,844,700	0.00	34,844,700
Të hyrat nga tarifa dhe konfiskimi i Bid depozitave në tenderët e shitjes	464,400	8,784,264	91,300	8,875,564
Bid depozitat për pjesëmarrje në tender	1,903,289	2,746,489	(2,746,489)	0.00
Të hyrat tjera	88,124	7,352,098	99,562	7,451,660
Kapitali themeltar i AKP	-	1,013,200	0.00	1,013,200
	Pagesat /Shpërndarjet			
Gjithsej pagesat /shpërndarjet	162,219,494	580,527,799	99,174,274	679,702,073
20% i punëtorëve i transferuar në BSPK	7,122,367	133,350,151	16,501,407	149,851,558
Ofruesi i Shërbimeve Profesionale (Autoriteti i Likuidimit)	136,309	16,137,239	480,868	16,618,107
Mallra dhe shërbime	1,562,728	17,885,792	2,147,691	20,033,483
Shpenzimet komunale	231,239	2,637,612	184,150	2,821,762
Tatimet	932,654	7,066,945	776,016	7,842,961
Vendimet e Gjykatave/ përmbauesve	8,605	2,524,527	386,286	2,910,813


(depozita dhe taksa)				
Transferimi i mjeteve 5% për mbulimin e aktiviteve të AKP-së	1,036,241	45,777,947	0	45,777,947
Të tjera	18,563	805,753	13,228	818,981
Pagesat ndaj kreditorëve të NSh-së	1,168,818	27,622,830	7,208,445	34,831,275
Fondet e transferuara Buxhetit të Kosovës	150,001,970	326,719,003	71,476,183	398,195,186
Gjendja bankare	(112,955,986)	275,159,950	(83,702,963)	191,456,987

Pranimet/të hyrat kanë të bëjnë me shitjet, qiratë e aseteve të NSh-ve dhe të hyrat tjera. Gjatë vitit 2020 pranimet/të hyrat ishin 15,471,311€. Në raport me vitin e kaluar kishte një zvogëlim të inkasimit të të hyrave për 33,792,197€, si rezultat i kufizimeve të aktiviteve gjatë pandemisë si dhe vendimit të Qeverisë që të pezullohet përkohësisht procesi i privatizimit.

Pagesat/shpërndarjet gjatë vitit 2020 ishin 99,174,274€, ku në raport me vitin e kaluar kishte zvogëlim për 63,045,220€. Ky zvogëlim i pagesave ka të bëjë edhe me fondet e transferuara në buxhetin e Kosovës prej 71,476,183€. Përveç fondeve të transferuara në Buxhetin e Kosovës këto pagesa përfshijnë edhe financimin prej 5% të aktiviteve të AKP-së, pagesën e 20% të punëtorëve, tatimet, pagesat ndaj kreditorëve dhe të tjera.

Grafiku 1. Pranimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2019-2020



Grafiku 2. Pagesat sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2019-2020

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2019 të Fondeve në Mirëbesim ka rezultuar në dy (2) rekomandime. FM kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. FM, ka dorëzuar vetëm një Raport të Progresit mbi Zbatimin e Rekomandimeve me 24 mars, me nëntë (9) ditë vonesë, bazuar në kërkesat e dala nga Rregullorja e Punës për Zbatimin e Auditimit dhe Planeve të Veprimit. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, një (1) rekomandim nuk ishte zbatuar dhe një (1) nuk është i aplikueshëm më. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 2.

Tabela 2 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet ndërmarra	Statusi
1.	Të hyrat	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj ripërtëritjen e kontratave me qëllim që shfrytëzimi i asetëve të NSH-ve të bëhet komfort kontratave valide dhe në bazë të rregullores së brendshme për qiratë.	Ky rast është në procedurë gjyqësore dhe deri në momentin e marrjes së vendimit nga gjykata ky rekomandim do të mbyllet.	Nuk është i aplikueshëm më
2.	Të hyrat	Kryesuesi i Bordit përmes drejtorit duhet të siguroj se mekanizmat e vendosura për këtë qëllim e monitorojnë dhe i shtojnë kontrollet të qiramarrësit që vonohen në kryerjen e pagesave të qirasë në mënyrë që arkëtimin i të hyrave të bëhet me kohë.	Nga mostrat e testuara kemi vërejtur se ende ka vonesa në pagesën e qirave.	Nuk është adresuar


Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Të hyrat	Kryesuesi i Bordit përmes Drejtorit Menaxhues duhet të siguroj që mekanizmat e kontrollit, e monitorojnë dhe i shtojnë kontrollet tek qiramarrësit që vonohen në kryerjen e pagesave të qirasë në mënyrë që arkëtimin i të hyrave të bëhet me kohë.
2.	Të hyrat	Kryesuesi i Bordit përmes Drejtorit Menaxhues duhet të siguroj se mekanizmat e vendosura për kryerjen e transfereve, i zbatojnë praktikatat e vendosura për të evituar gabimet eventuale gjatë kryerjes së transfereve.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Qerkin Morina, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm

Bujar Bajraktari, Udhëheqës i Auditimit



Ariana Berisha Rexhëbeqaj, Udhëheqëse e ekipit



Jehona Krasniqi, Anëtare e ekipit



Albana Kadriu, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA E KOSOVË - REPUBLIC OF KOSOVO	
KOSOVSKA AGENCIJA E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU	
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO	
II	
Nr. 3450	
Br. 1	
Kl. i Ri. 1	Data 23 JUL 2021
Es. Str. 1	Date 1
No. Pg. Prishtinë / Prishtina	

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Fundeve në Mirëbesim, për vitin 2020 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA E KOSOVË - REPUBLIC OF KOSOVO			
KOSOVSKA AGENCIJA E PRIVATIZIMIT			
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO			
Data e dorëzimit të Raportit 23.07.2021			
Klasifikimi i Dokumentit			
Procedura	Sh. i Dokumentit	No. i Prot. të Prot.	No. i Dokumentit
05	47	1279	1

z. Valon Tolaj

Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Data: 23 korrik 2021, Prishtinë

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.⁷ Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionin i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.